



The European Union's Cross-Border Cooperation Program

# MANUAL LIGJOR (PYETJE PERGJIGJE PER GRATE BIZNESMENE)

PERGATITI  
PROF ASS DR ERVIN KARAMUÇO





# CONTENTS

<b>PARATHËNIE</b>	4
<b>TE DREJTAT E GRAVE, DHE BARAZIA GJINORE</b>	5
A mbrohen grate nga shteti shqiptar ne parandalimin e diskriminimit gjinor?	5
<b>LEGJISLACIONI BUJQESOR DHE TREGTAR</b>	6
Egziston nje plan kombetar per nxitjen e aktivitetit bujqesor dhe si mund te perfitojne grate ne kete fushe?	6
Egzitrojne ligje per ngritjen dhe perfitimin nga aktivitete fitimprures ne bujqesi?	7
Çfare lloj aktiviteti mund te ushtroj ne bujqesi sipas ligjit?	7
Çfare pergjegjjesish dhe dokumentash me duhen per hapjen e nje aktiviteti bujqesor?	8
Çfare funksionesh kryen QKB dhe si te aplikoj per biznesin?	8
Çfare dokumentash me duhen per te aplikuar per hapje biznesi?	9
<b>LEGJISLACIONI TATIMOR MBI TE DREJTAT DHE DETYRIMET E BIZNESIT</b>	10
Çfare detyrimesh tatimore kam si aktivitet ambulant?	10
Çfare detyrimesh tatimore kam si fermer?	10
Çfare detyrimesh tatimore kam si person juridik?	11
Çfare lloj taksash duhet te paguaj per organet vendore?	12
Çfare lloj dokumentash dhe pajisjesh tatimore jam i detyruar te mbaje si biznes?	12
<b>LEGJISLACIONI I PROKURIMEVE DHE MASAT KUNDER KORRUPSIONIT</b>	13
Çfarë kuptohet me "specifikimet teknike"?	13
Çfarë është ankand elektronik?	13
Çfarë është procedura e hapur?	13
Çfarë është procedura e kërkeses se ofertes?	14
Si dorezohen dokumentat per tender?	14
Si vleresohen ofertat e tenderit?	14

Si te ankohe ndaj nje vendimi te padrejte te KPP?	14
Çfarë është korrupsioni dhe ku ta denonconi ate?	15
<b>INSPEKTIMET DHE KONTROLLI</b>	15
Sa lloje inspektimesh shteterore te zakonshme mund te kontrollojne biznesin tim dhe cilat jane kompetencat e tyre?	15
<b>MBESHTETJA DHE OFERTAT BANKARE</b>	17
Cilat jane disa nga bankat ne Shqiperi qe ofrojne mundesi financimi per biznesin?	17
<b>MBROJTJA SHOQERORE DHE SHENDETSORE NE MARREDHENIET E PUNES</b>	18
Kush perfiton nga sigurimi i detyrueshem shendetesor?	18
Cfare perfitohet nga sigurimi i detyrueshem shendetesor?	18
Cilat jane pergjegjesite e pronareve punedhenes?	19
Cfare eshte skema e kontributeve te sigurimeve shoqerore?	20
Cilat jane detyrimet e punedhenesit per sigurimet shoqerore?	20
Cilat jane llojet e pensioneve qe perfitohen nga sigurimet shendetesore?	21
Cilat jane detyrimet si punedhenes?	21
Cfare perfiton punemarresi nga mbulimi i sigurimeve shoqerore?	22
Si llogariten dhe kur paguhen sigurimet shoqerore?	22

## PARATHËNIE

Manuali ligjor që po ju vihet në dispozicion, është produkt i një projekti të sukseshëm ndërkuftar, i cili nëpërmjet aktiviteteve të tij, përqasi nevojat e grave në iniciativat dhe sipërmarrjet e biznesit, duke krijuar një frymë bashkëpunimi dhe shkëmbimi experience midis grupeve të tyre nga Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.

Manuali Ligjor u hartua dhe botua si një nevojë imediate, për të ofruar më shumë informacion praktik ligjor dhe administrativ në interes të grave në biznes, të cilat gjatë projektit, shprehën nevojën për tu pajisur më një udhërrëfyes të thejstë dhe të dobishëm legal, për të zhvilluar më tej sipërmarrjet e tyre në fushat respektive.

Ky dokument është një sintezë e legjislacionit tregtar, fiskal, doganor dhe bankar në Republikën e Shqipërisë, në të cilën janë përmbledhur dhe përshkruar shumë informacione dhe procedura utilitare për biznesin, duke patur si qëllim që lexuesit të jenë sa më shumë të informuar, të qartë dhe të vetëdijshëm mbi rëndësinë e veprimeve të tyre të biznesit në raport me legjislacionin në fuqi.

Shpresoj që nevoja për bashkëpunim, shkëmbim experience, dhe informacion ligjor që u zhvillua shumë sukseshëm në projektin ndërkuftar Maqedoni e Veriut-Shqipëri, të gjejë rrugën e vazhdimësisë nëpërmjet iniciativave të reja të përbashkëta rajonale, që sjellin dhe harmonizojnë edhe më shumë tregun ballkanik me qëllim integrimin e tij në familjen e madhe evropiane. Në këtë kuadër, edhe ky manual ligjor do të kontribuojë sadopak në këtë plan afatgjatë zhvillimor dhe prosperues.

## TE DREJTAT E GRAVE, DHE BARAZIA GJINORE

### A mbrohen grate nga shteti shqiptar ne parandalimin e diskriminimit gjinor?

**Deklarata e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Njeriut** sanksionon barazine e burrit dhe te gruas ne cdo aspekt jetesor, duke respektuar ne menyre te njejte vlerat e tyre ne shoqeri. **Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, ose e ashtuquajtura Konventa e Stambollit** e ratifikuar edhe nga Shqipëria, parashikon shpërndarjen e materialeve për edukimin e qytetarëve për të drejta të barabarta mes burrave dhe grave, me qëllim që të kapërcehen stereotipet për rolin e gruas dhe pozitën e saj vartëse, për respekt të ndërsjellë, për t'i dhënë grave rolin e partnerit të barabartë dhe respektin për integritetin dhe aftësinë profesionale të saj. **Sipas nenit 18 dhe 49 të Kushtetutës së Shqipërisë**, të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit. Askush nuk do të diskriminohet padrejtësisht për shkak të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare ose filozofike, fuqisë ekonomike, arsimimit, statusit social dhe kështu me radhë. Kushdo ka të drejtë për të fituar për jetesë me anë të punës juridike të cilën e ka zgjedhur ose pranuar. Secili është i lirë të zgjedhë profesionin e tyre, vendin e punës dhe sistemin e tyre të kualifikimit profesional. **Në bazë të Kodit te Punes** është i ndaluar është çdo lloj diskriminimi ndaj punonjësve në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, fesë apo besimit, mendimit politik, prejardhjes kombëtare ose sociale, lidhjeve familjare, personave me aftësi të kufizuara fizike ose mendore. Ligji siguron qasje të barabartë në punësim dhe trajtim, barazi gjinore në vendet e punës, punëdhënësit duhet në mënyrë të barabartë të trajtojnë burrat dhe gratë, sidomos në aspektin e qasjes së punësimit dhe kushtet e punës, promovimin dhe pagën, shëndetin dhe mirëqenien në punë (punëdhënësit janë përgjegjës për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për punëtorët) dhe pushimin e lehonisë. Ligji për marrëdhëniet e punës thekson mbrojtjen e grave që punojnë gjatë shtatzënisë dhe pushimit të lindjes. Punëdhënësi duhet të garantojë kushte të veçanta për gratë në punë, duke siguruar kushte të posaçme të punës, pushim lindjeje, mbrojtje kundër shkarkimit. **Ligji per Mbrojtjen nga Diskriminimi ne Shqiperi** garanton se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet dhe ka lidhje me shpalljen e vendeve të lira të punës, rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve, trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të

kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës, anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi. Ndalohet çdo lloj shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual, nga punëdhënësi përkundëjt një punëmarrësi ose një kërkuesi për punë ose midis punëmarrësve. Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura mësipër me qëllim përshpejtimin e barazisë në fushën e punësimit, nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen në mënyrë të përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe masat e posaçme ndërpriten kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

## LEGJISLACIONI BUJQESOR DHE TREGTAR

### **Egziston një plan kombëtar për nxitjen e aktivitetit bujqësor dhe si mund të përfitojnë gratë në këto fushë?**

Në bazë të Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural për shkak të nxitjes së kësaj dege të rëndësishme të të ardhurave kombëtare bruto të vendit dhe zhvillimin e tij të mëtejshëm, është miratuar Plani Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, i cili përfshin Strategjinë për bujqësi dhe Strategjinë për zhvillim rural. Plani nacional është i bazuar në analizën e situatës aktuale, objektivat afatmesme për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, programet e zhvillimit, zbatimit të këtyre projekteve, vlerësimin e efekteve dhe fondeve të nevojshme publike për zbatimin e këtyre qëllimeve. Plani kombëtar miratohet për një periudhë prej një apo më shumë vjet dhe përfshinë: kushtet, kriteret dhe procedurat për ndërmarrjen dhe zbatimin e masave të përgjithshme për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për Mbështetjen Bujqësore në Shqipëri synon të garantojë efektivitetin e masave të ndërmarra nga shteti për të inkurajuar qytetarët që të merren me këtë aktivitet. Mbështetja financiare është jetike për fillimin e aktivitetit bujqësor, sidomos për gratë sipërmarrëse. Mbështetje të këtilla financiare, mund të realizohen përmes buxhetit të shtetit, donatorëve ndërkombëtarë, veçanërisht për produktet organike që janë gjithnjë e më të rëndësishme për shëndetin e njeriut.

Programi për bujqësi dhe zhvillim rural i cili është pjesë e buxhetit të shtetit administrohet nëpërmjet Agjencisë për Përkrahjen e Bujqësisë dhe është krijuar një Fond Special i Mbështetjes. Përfituesit e fondit të programit janë prodhuesit bujqësor (fermerët), një grup prodhuesish bujqësor, persona fizikë dhe persona

juridikë të angazhuar në veprimtari bujqësore dhe aktivitete të tjera që lidhen me bujqësinë, personat fizikë dhe juridikë që lidhen me agro-industrinë dhe personat fizikë apo juridikë që ofrojnë shërbime për nevojat e prodhimit bujqësor dhe aktiviteteve të tjera rurale. Ky program kërkon të inkurajojë rritjen dhe përmirësimin e konkurrencës së aktivitetit bujqësor dhe industrisë përpunuese të produkteve bujqësore, menaxhimit të tokës dhe përmirësimin e mjedisit, përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe inkurajimin e tyre për të kryer aktivitete të ndryshme ekonomike në këtë fushë, inkurajimin dhe mobilizimin e potencialit zhvillimor lokal në zonat rurale, si dhe zhvillimin e nismave lokale, mbështetjen e iniciativave lokale dhe stimujve të tyre, duke përfshirë ato të angazhuara në veprimtari bujqësore, menaxherë pyjorë dhe akterë të tjerë lokalë që mund të mbrojnë dhe zhvillojnë trashëgiminë natyrore dhe kulturore lokale, të përmirësojnë vetëdijen mjedisore, por edhe për të promovuar produkte tipike, turizëm dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme.

**Nxitja dhe promovimi i prodhimit organik** është një nga fushat ku vlerësohet me rëndësi të veçantë të inkurajohen dhe të mbështeten gratë që do të jenë të vendosura të kryejnë veprimtari bujqësore për t'u përqëndruar në prodhimin organik që ofron më shumë përfitime, përkatësisht në prodhimin e ushqimit të shëndetshëm, të lirë nga pesticide të ndryshme që janë të dëmshme për shëndetin e njeriut, vendosjen e garantuar të produkteve organike në tregjet në vend dhe jashtë tij, çmime më të larta për produktet dhe fitime më të larta, sigurimi i asistencës së ekspertëve nga vendi dhe jashtë vendit për prodhimin e produkteve organike dhe mbrojtjen e tyre nga sëmundjet e ndryshme, asistencë më e madhe financiare për fillimin e prodhimit të ushqimit organik etj.

Është me rëndësi të veçantë që gratë që kryejnë veprimtari bujqësore të organizohen dhe të kërkojnë nga shteti të miratojë programe të posaçme që do të sigurojnë mbështetjen dhe promovimin e këtyre produkteve. Mbështetja financiare nga buxhetet e qeverisë lokale dhe qendrore për subvencionimin e grave që merren me prodhimin organikë që është më i zakonshëm dhe i kërkuar në tregjet në vendet shumë të zhvilluara.

### **Egzitojnë ligje për ngritjen dhe përfitimin nga aktivitete fitimprures ne bujqesi?**

**Ligji për Kooperativat e Bujqëve** parashikon jo vetëm menyren e organizimit të aktivitetit bujqësor, por edhe **përfitimet** potenciale nga përfshirja në kooperativat bujqësore. Këto përfitime janë se kooperativat bujqësore sigurojnë që personat që kryejnë veprimtari bujqësore t'i vendosin produktet e tyre në tregje. Anëtarësimi në kooperativa sjell përfitime të shumta mbi veprimtari të tjera ose forma të tjera organizative. Anëtarësimi në kooperativë do të reduktojë pasigurinë në lidhje me klasifikimin e produkteve bujqësore, do të sigurojë blerjen dhe grumbullimin e produkteve. Rritja e besimit të konsumatorëve në produktet e tyre që do të jenë të markuara dhe të njohura. Anëtarët e kooperativës do të jetë në gjendje për të siguruar cilësinë dhe sasinë e produkteve të nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregjeve dhe blerësve të tjerë. Të jesh një anëtar i një kooperativës bujqësore do të thotë konsolidimi i tokës dhe mbi këtë bazë janë rritur të ardhurat



nga toka bujqësore. Nëpërmjet anëtarësimit në kooperativës bujqësore, personat e angazhuar në veprimtarinë bujqësore mund të kenë një ndikim më të madh politik mbi qeverinë për miratimin e masave për të përmirësuar kushtet për subvencion të prodhimit nga shteti dhe duke marrë ndihmë profesionale nga autoritetet.

### **Çfare lloj aktiviteti mund te ushtroj ne bujqesi sipas ligjit?**

Ligji per Bashkepunimin e Shoqerive Bujqesore, ne baze te objektit te veprimtarise qe ushtrojne, i ndan keto te fundit ne disa lloje. **Shoqerite e bashkepunimit ne fushen e prodhimit bujqesor dhe ne marketing.** Keto shoqeri mund te prodhojne, te manipulojne, te perpunojne, te ruajne, te klasifikojne, te transportojne, te shperndajne, si dhe te tregtojne produktet bujqesore ose blegtorale ne gjendjen e tyre natyrale ose te perpunuar me pare. **Shoqeri te bashkepunimit ne veprimtarine e punes bujqesore.** Keto shoqeri mund te kryejne veprimtari te punes bujqesore per anetaret ose te tretet, duke perfshire dhe anetaret punetore. **Shoqeri te bashkepunimit per konsumin e lendeve dhe mallrave.** Keto shoqeri mund te kryejne veprimtari te furnizimit me mallra dhe sherbime te blera nga anetaret, te tretet ose te prodhuara nga vete shoqeria, per perdorim dhe konsum te anetareve ose te treteve. **Shoqeri te bashkepunimit per inputet.** Keto shoqeri mund te blejne, te perpunojne, te prodhojne dhe te fabrikojne me cfaredo lloj procesi ushqime per bagetine, plehra kimike, bime, farera, produkte fitosanitare, materiale, instrumente, makineri, impiante, produkte me prejardhje nga kafshet dhe ffaredo lloj produktesh te tjera, te nevojshme dhe tepershtatshme per zhvillimin e prodhimit, bujqesor dhe blegtoral. **Shoqeri te bashkepunimit per qellime te tjera ne fushen e bujqesise.** Keto shoqeri mund te ushtrojne cdo lloj veprimtarie tjeter te nevojshem qe favorizon dhe lehteson permiresimin ekonomik, teknik, ekologjik dhe te kushteve te punes te cfaredo lloj fermeri apo operatori ekonomik, i cili operon ne fushen e bujqesise dhe te blegtorise.

### **Çfare pergjegjesish dhe dokumentash me duhen per hapjen e nje aktiviteti bujqesor?**

Shoqeria bujqesore pergjigjet per detyrimet e saj me te gjithë pasurine aktuale dhe te ardhshme. Anetaret e shoqerise jane pergjegjes per detyrimet e shoqerise deri ne vleren e kontributeve te nenshkruara te kapitalit te shoqerise, qofshin ose jo te shlyera. Selia e shoqerise percaktohet ne statut, kryesisht, ne zonen ku kjo shoqeri kryen veprimtarine ose ku ka te perqendruar veprimtarine drejtuese. Shoqeria ka emertimin e saj, i cili percaktohet ne statut dhe qe duhet te permbaje fjalet "Shoqeri e bashkepunimit bujqesor". Per krijimin e shoqerise, numri minimal i anetareve te nevojshem duhet te jete 7. Ky numer mund te zmadhohet ose te zvogelohet pa asnje kufizim pergjate veprimtarise se shoqerise. Kapitali i shoqerise perbehet nga kontributet e anetareve, te cilat mund te jene ne para ose ne natyre. Kapitali ndahet ne pjese, te cilat zoterohen nga anetaret dhe perfaqesojne vleren e kontributit te tyre ne kapital. Kapitali minimal per krijimin e shoqerise se bashkepunimit bujqesor eshte 100 000 (njqind mije) leke. Statuti dhe Akti i themelimit te shoqerise nenshkruhet nga te gjithë nismetaret dhe permbajne te dhenat si identitetin e themeluesve dhe te administratorit, deklaraten e permbushjes se kriterëve per te qene anetar, emertimin e shoqerise, objektin e shoqerise, seline, kapitalin e

shoqërise dhe përqindjen e kapitalit të zotëruar nga secili anëtar. Këto dokumente të shoqëriave regjistrohen në Qendren Kombëtare të Biznesit

### **Çfare funksionesh kryen QKB dhe si të aplikoj për biznesin?**

Qendra Kombëtare e Biznesit mban Regjistrin Tregtar, kryen regjistrimet në regjistrin tregtar, lëshon certifikata, ekstrakte dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, trajton procedurat e licencimit, të autorizimit apo të lejeve, këshillon personat e interesuar për procedurat e regjistrimit të biznesit. Regjistri është një bazë të dhënash unike e subjekteve që kryejnë veprimtari ekonomike tregtare në Shqipëri. Regjistri përmban të dhëna, që i përkasin themelimit, veprimtarisë dhe çregjistrimit të subjekteve, çdo ndryshim në status dhe organizimin e subjektit tregtar, të dhëna, që i përkasin atij në lidhje me përfaqësimin, si dhe të dhëna të tjera, të parashikuara me ligj. Regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër bëhet me aplikim pranë çdo sporteli shërbimi të QKB-së, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Aplikimi për regjistrim mund të kryhet edhe në mënyrë elektronike, në përputhje me legjisllacionin për nënshkrimin elektronik. Subjektet që detyrohen të regjistrohen në regjistrin tregtar janë nder të tjera edhe personat fizikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike tregtare, shoqëritë e thjeshta, shoqëritë tregtare si dhe degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja.

Regjistrimi kryhet me dorëzimin e aplikimit përkatës, të cilit i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që regjistrohen. Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dhe nuk duhet të përmbajnë korrigjime ose fshirje të pavërtetuara, sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe përmbajtja e tyre duhet të duket qartë, të jetë e lexueshme dhe të lejojë marrjen e imazhit elektronik të dokumentit. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, aplikanti mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Personat fizikë regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, si dhe një kopje të dokumentit të identifikimit. Shoqëritë e thjeshta regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme, kontratën përkatëse dhe kopje të dokumenteve të identifikimit të anëtarëve.

### **Çfare dokumentash me duhen për të aplikuar për hapje biznesi?**

Për regjistrimin fillestar të personave fizikë janë të detyrueshme këto të dhëna:

1. të dhënat e identifikimit;
2. vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;
3. fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
4. specimeni i nënshkrimit (firmës) të personit fizik.

**Për regjistrimin fillestar të shoqërive të thjeshta janë të detyrueshme këto të dhëna:**

1. kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
2. fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar;
3. vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare;
4. të dhënat e identifikimit të anëtarëve;
5. vlera dhe lloji i kontributeve të anëtarëve;
6. dh) të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;
7. specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

**Për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare janë të detyrueshme këto të dhëna:**

1. emri;
2. forma;
3. data e themelimit;
4. të dhënat e identifikimit të themeluesve;
5. selia;
6. objekti, në qoftë se është i përcaktuar;
7. kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;
8. të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre.
9. specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

## LEGJISLACIONI TATIMOR MBI TE DREJTAT DHE DETYRIMET E BIZNESIT

### Çfare detyrimesh tatimore kam si aktivitet ambulant?

**Ambulanti**, është personi fizik, që ka mbushur moshën 16 vjeç, i vetëpunësuar, i cili tregton mallra ose shërbime për publikun pa pasur një vend biznesi fikso, që ushtron aktivitetin në njësi të vetme tregtimi të lëvizshme dhe lejohet të tregtojë në ambiente publike. Ambulanti, regjistrohet pranë drejtorisë rajonale tatimore të juridiksionit sipas ndarjes së organizimit administrativ. Është kusht që ambulanti të mos ketë një vend fikso biznesi dhe nuk mund të ushtrojë veprimtari në më shumë se një njësi tregtare. Administrata Tatimore në certifikatën e NIPT-it që i lëshon ambulantit është e detyruar që përpara emrit të tatimpaguesit të vendosë fjalën "Ambulanti". Ambulanti pasi regjistrohet ka detyrimin për të paguar sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Ambulantët, që kanë mbushur moshën 16 vjeç, që nuk janë të siguruar si punëmarrës ose si të vetëpunësuar në veprimtari ekonomike të vijueshme, paguajnë kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme për degën e pensioneve dhe për sigurimin e kujdesit shëndetësor. Personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, deklarojnë dhe paguajnë kontribut minimal mujor në shumën 4 696 lekë, nga të cilat, 3 200 lekë për sigurime shoqërore dhe 1 496 lekë për sigurimin e kujdesit shëndetësor. Ambulanti rregjistrohet ne organet tatimore duke dorëzuar, kërkesë me shkrim për regjistrim, Fotokopje të Kartës së Identitetit ose të Pasaportës të personit të vetëpunësuar, Formularin e regjistrimit të plotësuar, Lejen nga bashkia nën juridiksionin territorial dhe administrativ, që i vetëpunësuarit lejohet të tregtojë në vende publike të përcaktuara paraprakisht nga Bashkia dhe që ushtron aktivitetin në njësi tregtimi të vetme dhe të lëvizshme. Çregjistrimi behet me kërkesë të personit të regjistruar si ambulant, që paraqitet pranë drejtorisë rajonale tatimore ku është bërë regjistrimi.

### Çfare detyrimesh tatimore kam si fermer?

**Fermeri**, është prodhues bujqësor, i vetëpunësuar, që zhvillon aktivitetin me krahun e vet të punës dhe me mjetet e punës që disponon, në veprimtarinë e prodhimit bujqësor, pyjor dhe peshkimit. Fermerët të cilët shesin prodhimet e tyre tek sipërmarrësit (tregtarë), janë të detyruar të regjistrohen dhe të pajisen me certifikatën e NIPT-it. Aplikimi dhe pajisja me certifikatën e NIPT-it, bëhet nga vetë fermeri, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore të juridiksionit sipas ndarjes së organizimit administrativ. Për tu regjistruar ne organet tati more duhet paraqitur, aplikimi për regjistrim sipas formularit përkatës të plotësuar e nënshkruar nga kërkuesi, dokumenti origjinal të identifikimit (letërnjoftimit)/ose kopje të noterizuar të këtij dokumenti, i cili i bashkëngjitet aplikimit për regjistrim, vërtetimin origjinal lëshuar prej Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në bazë të të cilit vërtetohet aktiviteti prodhues bujqësor i fermerit.

Te dhena te tjera qe kerkohen jane edhe adresa e banimit, kontakte të personit, vendi i ushtrimit të veprimtarisë, prodhuese bujqësore, fusha e veprimtarisë prodhuese bujqësore, ku nëse fermeri, kryen disa veprimtari prodhuese bujqësore, atëherë citohen disa duke filluar nga ajo, që mban peshën kryesore, specimeni i nënshkrimit (firmës) të individit-fermer. Fermeri është i detyruar të deklarojë në Drejtorinë Rajonale Tatimore, ku është pajisur me çertifikatën e NIPT-it, ndryshimet në të dhënat e regjistruara të tilla si të dhënat e identifikimit, vendit të ushtrimit të veprimtarisë prodhuese bujqësore, për shkak të tjetërsimit të tokës bujqësore apo çdo ndryshim tjetër, në të dhënat e deklaruara në momentin e regjistrimit. Fermeri trajtohet si i vetepunësuar dhe ka detyrimet si i vetepunësuar, te cilat janë përmendur tek ambulanti.

### **Çfare detyrimesh tatimore kam si person juridik?**

Çdo tatimpagues, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Të ardhurat e tatueshme nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, etj. Të ardhurat e tatueshme apo fitimi i tatueshëm rezultojnë si diferencë midis të ardhurave gjithsej të realizuar gjatë periudhës tatimore me shpenzimet e njohura. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5%. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit. Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë

Këstet e parapagimeve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të llogaritura si më sipër për vitin ushtrimor, paguhet nga tatimpaguesit në afatet e mëposhtme:

- brenda datës 20 prill për tremujorin e parë,
- brenda datës 20 korrik për tremujorin e dytë,
- brenda datës 20 tetor për tremujorin e tretë,
- brenda datës 20 dhjetor për tremujorin e katërt.

Pagesa e kësteve të parapagimeve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin bëhet në bankat e nivelit të dytë ose Postës Shqiptare, nëpërmjet Urdhër-Pagesës përkatëse të gjeneruar nga sistemi informatik i tatimeve.

Fitimi i tatueshëm rezultojnë si diferencë e të ardhurave gjithsej të realizuar gjatë periudhës tatimore (viti kalendarik), me shpenzimet. Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin është 15%. Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) është një tatim

i përgjithshëm, mbi konsumin e mallrave dhe shërbimeve. TVSH-ja zbatohet si një tatim në përqindje, mbi çmimin e mallrave dhe shërbimeve dhe bëhet i pagueshëm, pasi më parë zbritet TVSH që rëndon drejtpërdrejt, elementet e kostos së mallrave dhe të shërbimeve. Tatimit mbi vlerën e shtuar i nënshtrohen të gjitha furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, të kryera kundrejt pagesës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një person i tatueshëm dhe të gjitha importet e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë. Person i tatueshëm për TVSH konsiderohet çdo person juridik, pavarësisht nga forma e organizimit të tij, i cili në mënyrë të pavarur kryen veprimtari ekonomike, cilido qoftë vendi dhe qëllimi ose rezultati i kësaj veprimtarie. Veprimtari ekonomike është çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra ose shërbime, përfshirë veprimtarinë nxjerrëse, bujqësore dhe aktivitetet profesionale.

### **Çfare lloj taksash duhet te paguaj per organet vendore?**

Në taksat vendore përfshihen:

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin
3. Taksa për zënien e hapësirave publike;
4. Taksa e tabelës;
5. Taksa të përkohshme

### **Çfare lloj dokumentash dhe pajisjesh tatimore jam i detyruar te mbaje si biznes?**

Tatimpaguesit janë të detyruar të mbajnë:

1. Librin e shitjeve, ku regjistrojnë në mënyrë kronologjike çdo shitje të kryer me faturë të thjeshtë tatimore si dhe totalin e shitjeve ditore të kryer me kuponë tatimorë;
2. Librin e blerjeve, ku regjistrojnë në mënyra kronologjike çdo blerje të kryer me faturë tatimore, me TVSH, me faturë të thjeshtë tatimore;
3. Libri i shpenzimeve dhe të ardhurave;
4. Librin e aktiveve të biznesit.

Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor.

# LEGJISLACIONI I PROKURIMEVE DHE MASAT KUNDER KORRUPSIONIT

## Çfarë kuptohet me "specifikimet teknike"?

Prokurimi publik bëhet nga Komisioni i Prokurimit Publik i autoriteteve kontraktuese. Specifikimet teknike në të vërtetë përshkruajnë karakteristikat e mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara nga oferta (përfshirë vizatimet, modelet, etj) dhe të cilat duhet të krijojnë kushte për konkurrencë të ndershme dhe të hapur midis kompanive të tenderimit dhe t'u mundësojnë atyre qasje të barabartë në të gjithë ofertuesit. Specifikimet teknike duhet të përcaktojnë qartë dhe në mënyrë neutrale fushën e punës së kërkuar, të përshkruajnë të gjitha termat dhe kushtet e rëndësishme për përgatitjen e ofertës, si dhe kërkesat teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale, si dhe mbrojtjen e mjedisit. Kërkesat në njoftimin e prokurimit publik duhet t'u ofrojnë ofertuesve një ide të qartë se çfarë kërkohet prej tyre, në mënyrë që ata të mund të përgatisin tenderin, të mos kenë dilema dhe të mos hezitojnë të marrin pjesë në tender.

## Çfarë është ankand elektronik?

Ky është një proces i prokurimit publik që përfshin një formë elektronike për paraqitjen e çmimeve, ndryshimeve dhe vlerave të reja në lidhje me disa elementë të ofertës, i cili pason një vlerësim individual të ofertave nga renditja e tyre përmes metodave të automatizuara të vlerësimit. Me ankandin faktikisht synon të ulë çmimin e ofruar më parë për furnizimin (produkte, shërbime ose vepra).

## Çfarë është procedura e hapur?

Në këtë procedurë publikohet një shpallje publike që përmban një përshkrim të prokurimit dhe kërkesat specifike procedurale. Të gjithë ofertuesit (ndërmarrjet) mund të paraqesin një ofertë dhe dëshmi të kërkesave nga shpallja. Komisioni për furnizime publike të organi kontraktues do t'i hap ofertat, do të verifikojë kualifikimet e ofertuesit, sipas kritereve të shpalljes dhe do të merr një vendim për zgjedhjen e ofertuesit më të mirë me të cilin duhet të lidhet një kontratë. Afati i paraqitjes së ofertave do të publikohet në shpallje, kështu që duhet të merret në konsideratë kur kompania është e interesuar të marrë pjesë në procedurën e prokurimit publik.

## Çfarë është procedura e kërkeses se ofertes?

Ky është lloji më i thjeshtë i procedurës dhe firmat e vogla shpesh mund ta përdorin. Komisioni i Prokurimit Publik mund ta përdorë këtë procedurë për kontrata, vlera e të cilave është nën pragun e vlerës më të ulët. Kjo procedurë

përdoret për një numër të kufizuar ofertuesish të cilët janë të ftuar nga Komisioni i Prokurimit Publik që të paraqesin ofertat sipas zgjedhjes së tyre. Komisioni mund të ftojë të paktën 5 ofertues që të zgjedhin, përveç kur zgjedhja është e pamundur për arsye teknike ose kur nuk ka konkurrencë dhe numri mund të jetë më i vogël. Kjo procedurë do të publikohet në Buletinin Publik, si dhe në faqen e internetit të Agjencisë për prokurimin publik.

### **Si dorëzohen dokumentat per tender?**

Në procedurën e hapur, në shpallje përveç kritereve, përcaktohet edhe vendi, adresa dhe afatin i fundit për dorëzimin e ofertës, gjuhën në të cilën është dorëzuar oferta, mënyrën dhe kushtet për marrjen e dokumenteve të tenderit. Ofertat mund të dorëzohen në mënyrë elektronike ose në formë letre në një zarf të mbyllur, dhe autoriteti kontraktues, me kërkesë, mund t'i sigurojë ofertuesit një datë dhe orën e pranimit të ofertës.

### **Si vleresohen ofertat e tenderit?**

Ofertat do të hapen nga Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) në datën, vendin dhe kohën e përcaktuar në dokumentacionin e tenderit (DT) pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave ose pas afatit të përcaktuar në njoftimin e kontratës. Të gjithë ofertuesit (ndërmarrjet) ose përfaqësuesit e tyre që kanë paraqitur ofertë do të thirren nga komisioni që të marrin pjesë në hapjen e ofertave. Emri dhe adresa e ofertuesit (firma) oferta e të cilit do të hapet, dokumentacioni si dhe çmimi i secilit tender do të lexohet me zë të lartë për të gjithë ofertuesve të pranishëm në hapjen e ofertave dhe do të regjistrohen në procesverbal. Kriteri i përzgjedhjes është oferta më e favorshme ekonomikisht, bazuar në kritere të ndryshme për secilën prokurim publik të veçantë, siç janë: cilësia, çmimi, teknike, estetike, karakteristikat funksionale, mbrojtja e mjedisit, shpërndarja, pajtueshmëria me afatet e ekzekutimit të kontratës etj. Në rast se ofertat dërgohen në formë elektronike, sistemi do të përpunojë automatikisht të dhënat, dhe vlerësimet dhe komentet gjithashtu do t'u ofrohen ofertuesve në mënyrë elektronike.

### **Si te ankoem ndaj nje vendimi te padrejte te KPP?**

Kundër vendimit për zgjedhjen e ofertës më të mirë, kompanitë, ofertat e të cilave nuk u pranua kanë të drejtë të ankojnë në Komisionin e Prokurimit Publik, i cili është kompetent për të trajtuar ankesat, dhe vendimi i tij është i formës së prerë në procedurën administrative. Ankesa do të paraqitet brenda 7 ditëve nga marrja e përgjigjes se oferta është refuzuar. Komisioni i Prokurimit Publik, pas pranimit të ankesës, pezullon vazhdimin e procedurës së dhënies së kontratës deri sa të merret një vendim për ankesën. Kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, pala e pakënaqur ka të drejtën e ngritjes së mosmarrëveshjes administrative para Gjykatës Administrative në Tiranë në shkallë të parë. Gjykata administrative do të pezullojë procedurën e prokurimit publik, procedurën e dhënies së kontratës për punimet, mallrat dhe shërbimet nga ana e autoriteteve kontraktuese ose për kryerjen e detyrimeve të dalura nga kontrata midis dy palëve kontraktuese deri në vendosjen pas padisë.



## Çfarë është korrupsioni dhe ku ta denonconi ate?

Korrupsioni publik perceptohet në përgjithësi si ryshfet kur një zyrtar direkt ose indirekt (përmes një tjetri) kërkon ose merr një dhuratë ose përfitim tjetër ose merr një premtim për një dhuratë ose përfitim tjetër për veten e tij për të kryer një akt zyrtar që nuk duhet të kryhet ose të mos kryejë një akt zyrtar që ai ose ajo do të duhet të kryejë. Ryshfeti konsiderohet të jetë një dhuratë, para ose përfitim tjetër për të arritur një qëllim të veçantë (p.sh. shmangia e pagesës së gjobitjes, mospagimi i taksave ose detyrimeve, mosplotësimi, etj.). Por korrupsioni është një term shumë më i gjerë sesa vetë ryshfeti - kjo vepër e paligjshme përfshin të ashtuquajturin ndikim të trafikimit për shembull: punësimi, regjistrimi në shkollë apo kolegji, përfitimet, tenderët, trajtimi jashtë vendit, etj. Korrupsioni ka pasoja të mëdha në ekonomi, pasi paratë publike përmes taksave dhe tarifave të tjera në vend që të përdoren për përfitimin e qytetarëve - investime në shëndetësi, arsim, mirëqenie sociale, infrastrukturë, derdhen në arkat e partive ose llogari bankare private. Sa më i zhvilluar të jetë vendi dhe sa më e lartë është ndërgjegjja, niveli i korrupsionit është shumë i ulët dhe anasjelltas. Për të parandaluar veprime të tilla të paligjshme, personat ose firmat duhet të raportojnë ata zyrtarë që kërkuar ryshfet ose shërbime të tjera (punësimin e një të afërmi, blerjen e mallrave me një çmim dyqani, dreka falas në restorante, etj.) Dhe të jenë të vetëdijshëm që ata po mbrojnë biznesin e tyre. Organi përgjegjës për parandalimin e korrupsionit, Prokurori, Polici, Drejtues të Doganave dhe Tatime, drejtues të institucionit inspektues të tjera, OJQ-të që merren me luftën kundër korrupsionit, media etj.

## INSPEKTIMET DHE KONTROLLI

### Sa lloje inspektimesh shtetërore të zakonshme mund të kontrollojnë biznesin tim dhe cilat janë kompetencat e tyre?

Inspektorati Shtetëror i Punës është organ shtetëror i organizuar në nivel qendror dhe vendor. Misioni i përgjithshëm i Inspektoriatit Shtetëror që mbulon fushën e punës është kontrolli, konstatimi, këshillimi, njoftimi, formimi, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe sanksionimi. Inspektoriatit Shtetëror që mbulon fushën e punës ngarkohet të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë, që inspektorët e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave, t'u japë të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efektive të shqyrtimit të dispozitave ligjore, të vëre në dijeni autoritetin përgjegjës për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozi-

tat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes. Për të siguruar zbatimin e dispozitave ligjore, nënligjore dhe administrative, inspektori dhe kontrollori i punës janë të autorizuar të kryejnë ekzaminime, kontrole dhe hetime në mjediset e punës. Të intervistojnë punëmarrësit vetëm ose në praninë e punëdhënësit apo të përfaqësuesit të tij për kushtet e punës. Të dokumentojnë të gjitha shkeljet e vëna re gjatë inspektimit nëpërmjet fotografimit, regjistrimeve audio dhe video. Të verifikojnë regjistrat apo dokumentet e tjera dhe të bëjnë kopjet e tyre kur e shohin të arsyeshme. Marrja e kopjeve, sekuestrimi i dokumentave dhe trajtimi i informacionit, që pasqyrohet në to, behen në përputhje me ligjin për inspektimin. Për rastet e shkeljes së legjislacionit të punës, inspektori i punës vendos gjobë. Kunder gjobave dhe masave të tjera, mund të behet ankimi në gjykatën administrative.

**Administrata tatimore** kontrollon deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta. Kontrolli i tatimpaguesit bazohet në deklaratat e dhëna nga tatimpaguesi, si dhe në librat, regjistrimet e informacionin e dhënë nga palët e treta ose në përputhje me mënyrat alternative të vlerësimit. Administrata tatimore kontrollon saktësinë e të gjitha dokumenteve, që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore, si dhe çdo dokument tjetër me rëndësi për përcaktimin e detyrimit tatimor. Zgjedhja e tatimpaguesve, që kontrollohen, bëhet në bazë të analizës së vlerësimit të riskut, të kryer nga administrata tatimore, për të identifikuar tatimpaguesin, i cili ka më shumë rrezik për ta shkelur legjislacionin tatimor. Për rastet e shkeljes së legjislacionit tatimor, inspektori i tatimeve punës vendos gjobë. Kunder gjobave dhe masave të tjera, mund të behet ankimi fillimisht në Komisionin e Apelit Tatimor dhe me tej në gjykatën administrative. Kunder veprimeve dhe masave tatimore, personi mund të paraqesë ankimi edhe tek Avokati i Tatimpaguesve, i cili mbron interesat e tatimpaguesve në marrëdhëniet me organet tatimore. Ai autorizohet të investigojë të gjitha kërkesat e tatimpaguesve, që përmbajnë probleme të administrimit të tatimeve, si vonesa administrative të paarsyeshme, gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektimi i procedurave tatimore apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë.

**Inspektori i kontrollit të ushqimit dhe i ushqimit për kafshë AKU** ka të drejtë të hyjë, të kontrollojë dhe të fotografojë shkeljet e konstatuara në stabilimentin ushqimor ose në çdo ndërtesë tjetër ku ushqimi prodhohet, përpunohet dhe shpërndahet, me përjashtim të vendeve të banimit. Kur inspektori i kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë AKU, gjatë kontrollit zyrtar, zbulon ose ka arsye për të dyshuar për një shkelje të dispozitave të këtij ligji, merr masat e nevojshme për t'u siguruar që shkelja do të korrigjohet nga operatori i biznesit ushqimor. Pronari, poseduesi, personi përgjegjës, i punësuari në stabiliment, që ndodhen në stabiliment në çastin e kontrollit, duhet të japin informacionin dhe ndihmesën e kërkuar nga inspektori i ushqimit dhe ushqimit për kafshë AKU. AKU ka të drejtë të vendose gjobe për shkeljet e konstatuara, kunder të cilave mund të ankohen në gjykatë.

## MBESHTETJA DHE OFERTAT BANKARE

### Cilat jane disa nga bankat ne Shqiperi qe ofrojne mundesi financimi per biznesin?

Bankat kryesore ne Shqiperi qe ofrojne mbeshtetje per biznesin e vogel dhe qe kane portofolin me te madh jane Credins Bank, ProCredit Bank, Intesa SanPaulo Bank, Raiffesen Bank dhe Banka Kombetare Tregtare. Keto banka japin mundësinë e financimit te bizneseve të cilat plotësojnë kushtet e mjaftueshmërisë së kolateralit sipas procedurave kredituese të bankës ose ne raste te vecanta edhe pa kolateral.

**Banka Credins** ofron financim per cdo aktiviteti fitimprures që gjeneron të ardhura nga biznesi apo investon në këtë bisnes. Kufiri maksimal i ekspozimit të klienteve Mikro nuk mund të tejkalojë shumën 14.000.000 Lekë ose ekuivalenti në valutë të huaj. Klientët individë të cilët i sigurojnë të ardhurat e tyre nga biznesi, klasifikohen në këtë kategori financimi nëse aplikojnë për Kredi Konsumatore.

**Banka Pro Credit Bank** ofron kredi për Investime me financim afatgjatë për çdo biznes që ushtron aktivitet në fushën e prodhimit, tregtisë dhe shërbimeve, mbështetur në një analizë të plotë financiare si dhe në planin e investimit. Kredia për investime ofron financim për të blerë, zgjeruar apo rikonstruktuar ambiente të biznesit tuaj (*zyra administrative, ambiente prodhimi*) si dhe për të blerë pajisje apo makineri të reja ose të përdorura të nevojshme në biznesit tuaj.

**Banka Intesa San Paulo Bank** ofron mundesi për financim afatgjatë, për projektet e investimeve që nuk mund të kryhen vetëm me kapital. Kredia mund të përdoret për rritje të biznesit ose nisjen e një projekti të ri. Banka akordon kredinë për një qëllim të caktuar që lidhet me financimin e investimeve, prokurimin e ndonjë aktivi thelbësor nga ana e sipërmarrësit për zhvillimin e aktivitetit të biznesit të tij.

**Raiffeisen Bank** ofron kredi për investim dhe siguron mbështetjen financiare për rinovimin e teknologjisë së biznesit duke mundësuar blerjen e pajisjeve/makinereve të reja ose të përdorura.

**Banka Kombetare Tregtare** ofron kredi për investime. Nëpërmjet kësaj kredie BKT ju ofron mundësinë për të hapur një biznes të ri si dhe për të zgjeruar atë aktual. BKT ju financon për blerjen e linjave të prodhimit, ndërtesave, aktiveve të tjera fikse, ndërtimin, rinovimin dhe zgjerimin e biznesit tuaj.

## MBROJTJA SHOQERORE DHE SHENDETSORE NE MARREDHENIET E PUNES

### Kush perfiton nga sigurimi i detyrueshem shendetesor?

Sigurimi i detyrueshem shendetesor mbulon, gjithashtu, kategorite e meposhtme te personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve te te cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime te tjera te percaktuara me ligj:

1. personat qe perfitojne nga Instituti i Sigurimeve Shoqerore;
2. personat qe perfitojne ndihme ekonomike ose pagesen per aftesine e kufizuar, ne perputhje me legjislacionin perkates;
3. personat e regjistruar si te papune-punekerkues ne Sherbimin Kombetar te Punesimit;
4. shtetasit e huaj azilkerkues ne Republikën e Shqipërisë;
5. femijet nen moshen 18 vjeç;
6. nxenesit e studentet nen moshen 25 vjeç, me kusht qe te mos kenë te ardhura nga veprimtari ekonomike.

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve mbledh kontributet per sigurimin e detyrueshem shendetesor nga punedhenesit, per punonjesit dhe te vetepunësuarit dhe ia transferon ato Fondit, ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi. Instituti i Sigurimeve Shoqerore mbledh dhe i transferon Fondit kontributet per sigurimin e detyrueshem shendetesor te te vetepunësuarve ne bujqesi (fermerëve). Fondi eshte pergjegjes per llogaritjen dhe mbledhjen e kontributeve te sigurimeve shendetesore vullnetare. Fondi mbledh kontributin nga Buxheti i Shtetit per popullsinë ekonomikisht joaktive

### Cfare perfitohet nga sigurimi i detyrueshem shendetesor?

Sigurimi i detyrueshem financon paketat e shërbimeve te sigurimit te detyrueshem, ku përfshihen:

1. vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekesore ne qendrat e kujdesit shendetesor paresor publik dhe ne spitalet publike;
2. vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekesore ne dhenes privat te kujdesit paresor dhe spitale private;
3. barnat, produktet dhe trajtimet mjekesore nga dhenes te kontraktuar shërbimesh shendetesore

Fondi i sigurimit të detyrueshëm shëndetësor nuk financon shërbime të kujdesit shëndetësor ndaj personave që nuk janë të siguruar, me përjashtim të rasteve të urgjencës mjekësore, si dhe të paketës së kontrolleve periodike parandaluese në popullatë

### **Cilat jane pergjegjesite e pronareve punedhenes?**

Punëdhënësit janë përgjegjës për regjistrimin te Fondi të punëmarrësve të tyre dhe për informimin e Fondit për:

1. numrin e personave që kanë siguruar;
2. emrat e personave të siguruar dhe numrin e sigurimit;
3. pagat e personave të siguruar;
4. masën e kontributit të personave të siguruar;
5. periudhën e punësimit.

Personat, subjekt i sigurimit shëndetësor të detyrueshëm, regjistrohen në Fond brenda 30 ditëve nga data që bëhen subjekt i detyrimit për të paguar kontribute. Personat juridikë ose fizikë, brenda dy ditëve pune pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore, deklarojnë në organin tatimor listën e të punësuarve, pagën përkatëse, përfshirë për personin fizik edhe punonjësit e papaguar të familjes mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht. Për personat fizikë të vetëpunësuar pa punëmarrës dhe pa punonjës të papaguar të familjes mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon dhe bashkëjeton ligjërisht, pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore, ky deklarim në organin tatimor bëhet të paktën 3 ditë përpara afatit të paraqitjes së deklaratës, por llogaritja e detyrimit të kontributeve shëndetësore bëhet me efekte nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në administratën tatimore.

Personi juridik dhe fizik i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë, në formë elektronike, në organin tatimor të dhënat e detyrimeve për kontributet në total dhe për çdo individ. Personat juridikë dhe fizikë që janë të detyruar të paguajnë kontribute deklarojnë, në formë elektronike, në organin tatimor, të dhënat e detyrimeve për kontributet, sipas deklaratës përkatëse, ku, përveç të tjerave, deklarohet për çdo person emri e mbiemri, numri personal, paga, shuma për t'u paguar e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, si dhe e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Pagesa e kontributeve per sigurimet shendetesore mbahet ne masen 3.4% te pages bruto nga ana e organeve tatimore sipas kalendarit te pagesave periodike qe kryhen nga ana e subjekteve juridike apo te vetepunesuarve. Kontributet e detyrueshme të sigurimit shëndetësor të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, e cila nuk mund të jetë më e vogël nga paga minimale

e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Paga minimale mujore për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga periudha Dhjetor 2018, është 26 000 leke (njëzet e gjashte mijë).

### **Cfare eshte skema e kontributeve te sigurimeve shoqerore?**

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të punëdhënësit për punëmarrësin dhe kontributet e vetë punëmarrësit llogariten sipas nivelit të përcaktuar mbi pagën bruto të punëmarrësit dhe shtesat e tjera me karakter të përhershëm që lindin nga marrëdhëniet e punës, brenda një page bruto minimale dhe nivelit maksimal të pages, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore. Skema e sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë është si vijon:

Totali i kontributit të sigurimit shoqëror 24.50 %

1. Dega e sigurimit të sëmundjeve 0.30 %
2. Dega e sigurimit të barrëlindjeve 1.40 %
3. Dega e sigurimit të pensioneve 21.60 %
4. Dega e sigurimit të aksidenteve 0.30 %
5. Dega e sigurimit të papunësisë 0.90 %

### **Cilat jane detyrimet e punedhenesit per sigurimet shoqerore?**

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për personin e vetëpunësuar, përfshirë punëdhënësin e vetëpunësuar, llogariten si përqindje mbi një pagë bruto, jo më të ulët se paga minimale në shkallë vendi dhe jo më të lartë se paga maksimale, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore për punonjësin e papaguar të familjes llogariten mbi pagën minimale në shkallë vend. Personi juridik dhe fizik i detyruar për të paguar kontribute, për çdo periudhë, duhet të deklarojë, në formë elektronike, në organin tatimor të dhënat e detyrimeve për kontributet në total dhe për çdo individ. Personat juridikë dhe fizikë që janë të detyruar të paguajnë kontribute deklarohen, në formë elektronike, në organin tatimor, të dhënat e detyrimeve për kontributet, sipas deklaratës përkatëse, ku, përveç të tjerave, deklarohet për çdo person emri e mbiemri, numri personal, paga, shuma për t'u paguar e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të sigurimeve shëndetësore, si dhe e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi. Kontributet paguhen në bankat, te cilat kanë marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Punëdhënësi duhet të mbajë regjistrime për periudhën e marrëdhënieve të punës dhe shumat e paguara në para ose si përfitime në natyrë, për çdo punëmarrës. Këto regjistrime u vihen në dispozicion punonjësve të autorizuar të administratës tatimore sa herë që kërkohet prej tyre. Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, mbahen kamatevonesat për pagese të vonuar. Kamatevonesat nuk falen nga asnjë autoritet. Çdo person, që detyrohet të paguajë kontribute,

gëzon te drejtën e apelimit për vlerësimin e kontributit shtese te kamatevonesave ose gjobave. Çdo punëmarrës ka te drejtën e apelimit për llogaritjen e vlerës së kontributit, te mbajtur nga punëdhënësi.

### **Cilat jane llojet e pensioneve qe perfitohen nga sigurimet shendetesore?**

Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas tabelave të daljes në pension pleqërie, bazuar ne moshë dhe vite siguri, shumëzuar me pensionin social. Shtesa do të jetë 1% për vit siguri shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve, gjatë gjithë historisë së tij kontributive. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se pensioni social.

Pensioni i reduktuar i pleqërisë është kur personat që kanë periudha siguri kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension, nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës, ose të vetëpunësuar. Masa e pensionit të reduktuar të pleqërisë është pjesë e pensionit të pleqërisë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i pleqërisë shumëzuar me del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit para mbushjes së moshës, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit është 0.6 % në muaj.

Nga pjesëmarrja në skemën e sigurimeve shoqërore (Vulnetare, te detyrueshme, shtetërore ose private) dhe shëndetësore përfitohen të gjitha llojet e pensioneve:

- Pension pleqërie;
- Pension pleqërie i reduktuar;
- Pension familjar;
- Pension invaliditeti;
- Pension i pjesëshëm invaliditeti;
- Shërbim shëndetësor dhe rimbursim ilaçesh.

### **Cilat jane detyrimet si punedhenes?**

- Në mbështetje të Kodit të Punës punëdhënësi është i detyruar të nënshkruajë një kontratë pune me punëmarrësit, me kohë të plotë ose të pjesëshme;
- Punëdhënësi duhet të mbajë regjistra për periudhën e marrëdhënieve të punës dhe shumat e paguara për çdo punëmarrës, me kohë të plotë ose të pjesëshme;
- Të bëjë sigurimin e çdo punëmarrësi, me kohë të plotë ose të pjesëshme, duke filluar nga data e fillimit të punës, sipas përcaktimit në kontratën e punës ose në aktin e emërimit;

- Të bëjë llogaritjen, deklarin dhe pagesën e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, brenda afateve të përcaktuara për çdo punëmarrës.
- Pagesa e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kryhet nga punëdhënësi, sipas afateve të përcaktuara me ligj.
- Punëdhënësi ka detyrim ligjor për llogaritjen, deklarin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe masën e duhur. Listëpagesa është një deklaratë e subjektit, në të cilën evidentohen kontributet individuale, dhe si e tillë, në mbështetje të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" tatimpaguesi që nuk lëshon deklaratën tatimore në afat dënohet me gjobë me 10 000 lekë, për çdo deklaratë tatimore.
- Punëdhënësi, i cili nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendrike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së kontributeve të papaguara, detyrohet të paguajë edhe një gjobë 10 000 lekë për çdo rast.
- Punëdhënësi duhet të dorëzojë në formë elektronike deklaratën "Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi" dhe të paguajë rregullisht sipas afateve të caktuar të gjitha detyrimet për kontributet. Në këtë kuptim, çdo tatimpagues, punëdhënësi, pavarësisht nga pamundësia e tij financiare për të paguar të gjitha detyrimet për kontributet, është i detyruar që brenda afateve të caktuara, të paguajë tërësisht pjesën e detyrimeve për kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve.
- Listëpagesa është dokumenti bazë për dhënien dhe llogaritjen e përfitimeve për çdo punonjës, si dhe vërtetimeve të kërkuara prej tyre.

### **Cfare perfiton punemarresi nga mbulimi i sigurimeve shoqerore?**

Kur punëmarrësi është i sëmurë ose përkujdeset për fëmijën e sëmurë, që ka në ngarkim, të vërtetuar me raporte mjekësore, kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore deri në ditën e 14 me raport mjekësor deklarohen njëloj sikur punëmarrësi të mos jetë i sëmurë dhe paguhen sipas përcaktimit në Kodin e Punës. Kur punëmarrësi vazhdon me raportin mjekësor pa ndërprerje mbi 14 ditë, i siguruar ka të drejtë të marrë përfitime për paaftësi të përkohëshme nga fondet e sigurimeve shoqërore, të cilat llogariten nga punëdhënësi në formularim përkatës dhe dërgohen për konfirmim dhe pagesë në organet e sigurimeve shoqërore në rrethe. Shuma e pagesës së llogaritur për paaftësinë e përkoshme në punë për çdo punëmarrës, kalon në llogarinë personale të personit pranë bankës të nivelit të dytë për kryerjen e pagesës në lekë.



## Si llogariten dhe kur paguhen sigurimet shoqërore?

Për kontributet e sigurimeve shoqërore ju paguani 23% të pagës minimale mujore prej 26,000 lekë; Për kontributet e sigurimeve shëndetësore ju paguani 3,4% të dyfishit të pagës minimale mujore prej 26,000 lekësh.

Kontributet e sigurimeve shoqërore për personat e punësuar në subjektet juridike apo fizike llogariten mbi bazën e pagës bruto mujore brenda kufirit të pagës minimale në shkallë vendi dhe kufirit të pagës maksimale për efekt të llogaritjes të kontributeve të sigurimeve shoqërore të miratuara me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore ndahen në përqindje mbi pagën bruto mujore, sipas degëve të sigurimit:

- Sëmundjeve (paaftësi e përkohshme),
- Barrë lindjeve,
- Pensioneve,
- Aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale,
- Papunësisë.

Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për një të punësuar paguhen 27.9% të pagës bruto mujore.

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paguhen çdo tremujor, brenda datës 20 të muajit të parë, pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik. Pra jo më vonë se datat: 20 Prill, 20 Korrik, 20 Tetor, 20 Janar.





